

20110180417

L I G J

PËR GARANCI TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE NDAJ DETYRIMEVE SIPAS MARREVESHJES PËR HUA, TË DEDIKUAR PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “SISTEMI KRYESOR TRANSPORTUES NGA MS BROD GNEOTINO DERI NË SUVODOLL – LOT 3” QË DO TË LIDHET NDERMJET DOJCE BANKES DHE SHA ELEM

Neni 1

Republika e Maqedonise e garanton permbushjen e detyrimeve dhe permbushjen e dispozitave nga Marreveshja për hua të dedikuar për projektin “Sistemi kryesor transportues nga MS Brod Gneotino deri në Suvodoll – LOT 3” që do të lidhet ndermjet Dojce Bankes dhe SHA ELEM në shume prej 16 000 000 eurosh, në afate dhe kushte të parapara në Marreveshjen për hua, nese SHA ELEM nuk i permbush dhe servison detyrimet nga Marreveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji percaktohen me Marreveshjen për hua, që do të lidhet ndermjet Dojce Bankes dhe SHA ELEM për projektin “Sistemi kryesor transportues nga MS Brod Gneotino deri në Suvodoll – LOT 3”.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marreveshja për hua nga neni 1 i ketij ligji, si dhe servisimin e huas do ta beje SHA ELEM nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të percaktuara në Marreveshjen për hua.

Neni 4

Huaja nga Marreveshja nga neni 1 i ketij ligji do të paguhet në 17 keste të barabarta gjysmevjetore. Pagesa e pare duhet të filloje gjashte muaj pas fillimit të aktiviteteve të projektit, por jo më vonë se 27 shkurti 2012.

Shkalla kamatore eshte shkalle variabile kamatore EURIBOR plus 1,55% në vit.

Neni 5

Në afat prej 30 ditesh nga data e lidhjes së Marreveshjes për hua nga neni 1 i ketij ligji, për mjetet e huas do t'i paguhet provizion i njehershem Dojce Bankes në shume prej 0,625% nga shuma e huas.

Për shumen e mjeteve të paterhequra të huas, në nivel vjetor i paguhet provizion Dojce Bankes në shume prej 0,625% nga shuma e huas.

Provizioni nga paragrafi 2 i ketij neni paguhet në tremujor nga data e lidhjes së Marreveshjes për hua.

Për detyrimet lidhur me pagesen e huas nga neni 1 i ketij ligji që nuk do të paguhen në afatet e parapara, do të paguhet kamate ndeshkuese në lartesi të shkalles kamatore të zmadhuar për 2% në vit.

Për detyrimet tjera lidhur me huan nga neni 1 i ketij ligji që nuk do të paguhen në afatet e parapara, do të paguhet kompensim i demit në lartesi të shkalles kamatore të zmadhuar për 2% në vit.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella që dalin nga Marreveshja për hua dhe Marreveshja për garanci, Ministria e Financave dhe SHA ELEM do të lidhin marreveshje të vecante.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.